



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 132/2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 53/2014,
“PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 53/2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 7 shfuqizohet.

b) Shkronja “a”, e pikës 19, ndryshohet si më poshtë:

“a) pjesëmarrja e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë;”.

c) Paragrafi i fundit, i pikës 19, ndryshohet si më poshtë:

“Ngjarja e sigurimit konsiderohet se ndodh në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për vendosjen e subjektit anëtar të skemës në likuidim të detyruar ose të vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankën anëtare të skemës.”.

ç) Pikat 20 dhe 26 shfuqizohen.

d) Pas pikës 34 shtohet pika 35 me këtë përmbajtje:

“35. “Ndërhyrje e jashtëzakonshme” është procesi i përcaktuar në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.”.

Neni 2

Në nenin 8, pika 2, shkronja “c”, fjala “kujdestarinë” zëvendësohet me fjalët “ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

Neni 3

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në pikën 6, fjala “kujdestari” zëvendësohet me fjalët “ndërhyrje e jashtëzakonshme”.
- b) Në pikën 8, fjalët “e kujdestarisë” zëvendësohen me fjalët “e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.
- c) Në pikën 10, fjalët “të kujdestarisë” zëvendësohen me fjalët “të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.

Neni 4

Në nenet 21, pika 3, dhe 65, pika 3, fjala “kujdestari” zëvendësohet me fjalët “ndërhyrje e jashtëzakonshme”.

Neni 5

Në nenin 30, pika 1, shkronja “b”, fjala “ndërhyrjen” zëvendësohet me fjalët “ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

Neni 6

Në nenin 36, pika 1, shkronja “a”, fjalët “të transferimit të mjeteve financiare në shitjen e bankës ose themelimin e bankës urë nga Agjencia,” zëvendësohen me fjalët “pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjeteve financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 7

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Fjalja e dytë, e pikës 1, hiqet.
- b) Në pikën 7, fjalët “ose të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës ose bankën-urë” zëvendësohen me fjalët “ose të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjeteve financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 8

Neni 40 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 42 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në pikën 7, fjalët “si dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës e krijimin e bankës-urë” zëvendësohen me fjalët “si dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim

mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””;

b) Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Fondet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave, nuk mund të bllokohen, të sekuestrohen apo t’i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm, përveç qëllimit për të cilin janë krijuar.”.

Neni 10

Në nenin 43, pika 1, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “gj” ndryshohet si më poshtë:

“gj) merr pjesë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

b) Shkronja “j” shfuqizohet.

c) Pas shkronjës “m” shtohet shkronja “m/1” me këtë përmbajtje:

“m/1) administron fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

ç) Shkronja “nj” ndryshohet si më poshtë:

“nj) përfiton financime shtesë, në veçanti për kompensimin e depozitave të siguruar ose për pjesëmarrjen e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 11

Në nenin 52, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “t” ndryshohet si më poshtë:

“t) vendos për kthimin e fondit të kompensimit të depozitave në mjete likuide, për të përmbushur detyrimet ndaj depozituesve të siguruar, në rast ngjarjeje sigurimi, si dhe për pretendimin e Agjencisë për tagrat e ceduara nga kompensimi i depozituesve;”.

b) Në shkronjën “u”, fjalët “dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës dhe krijimin e bankës-urë” ndryshohen me fjalët “dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 12

Në nenin 60 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) pjesëmarrjen e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

b) shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative për zbatimin e procesit të kompensimit, sipas neneve 38 e 39, të këtij ligji, si dhe për pjesëmarrjen e Agjencisë me tranferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miraturar në datën 22.12.2016